



**SHERBIMI SOCIAL**

### #30 KORRIKU I DEDIKOHET NDËRGJEGJËSIMIT KUNDËR TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE



Në kuadër të Ditës Botërore kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Qendra Kombëtare e Trajtimit të Viktimave të Trafikimit zhvilloi aktivitete me natyrë informuese dhe ndërgjegjësuere në Qendrën Kombëtare Tranzitore të Emergjencave dhe Qendrën Komunitare Shkozë.

Fokusi i aktivitetit ishte në informimin mbi fenomenin e trafikimit dhe parandalimin e tij përmes njohjes së faktorëve të riskut. Trafikimit mund t'i themi STOP vetëm duke qenë të ndërgjegjësuar mbi të.

### #ZGJIDHJE AKTIVE PËRMES PUNËSIMIT PËR FAMILJET NË NEVOJË



Brunilda është nënë e dy fëmijëve dhe ka qenë përfituese e skemës së ndihmës ekonomike. Pasi kreu një kurs formimi profesional u punësua në një biznes privat në Kuçovë, falë bashkëpunimit të Shërbimit Social Shtetëror me Shërbimin Kombëtar të Punësimit.

Ne llojmë gjithmonë për zgjidhje aktive dhe integrim në shoqëri përmes punësimit.




**SHERBIMI SOCIAL**

## #DREJTORIA E KONTROLLIT TË PAGESAVE TË NE DHE PAK

Drejtoria e Kontrollit të Pagesave të NE dhe PAK gjatë muajit Korrik ka përfunduar dhe dërguar draft raportin përfundimtar të kontrollit në Drejtorinë Rajonale të Shërbimit Social Shtetëror Lezhë për përmirësimin e zbatimit të legjislacionit për Ndhmën Ekonomike.

Është përgatitur raporti i vlerësimit të situatës së skemës së NE dhe janë nxjerrë raporte të veçanta për secilin qark dhe është monitoruar procesi i mbledhjes së Këshillave Bashkiakë për marrjen e vendimeve.

Është monitoruar procesi i verifikimit automatik dhe vendimmarrjes për 12 Drejtoritë Rajonale të SHSSH. Janë monitoruar kontrollet e kryera nga Drejtoritë Rajonale sipas planifikimit të bërë për muajin.



## #DREJTORIA E SHËRBIMEVE SOCIALE

Gjatë muajit Korrik, Drejtoria e Shërbimeve Sociale ka menaxhuar 7 raste VT/VMT dhe është koordinuar puna për pritjen e një rasti në kufi.

Është mbledhur Komisioni për Fëmijët dhe ka marrë vendim për sistemimin e 3 fëmijëve në institucionet e përkujdesit shoqëror.

Është mbledhur Komisioni për Statusin e Jetimit, ku është shqyrtuar dokumentacioni për 73 raste, nga të cilat 34 raste kanë përfituar këtë status për herë të parë, 35 libreza janë rinovuar dhe 4 raste janë refuzuar.

Komisioni për të Moshuarit ka shqyrtuar 13 raste të moshuarish për t'u sistemuar në IPSH, janë sistemuar 5 dhe janë transferuar 3 raste.





SHERBIMI SOCIAL

### #INSTITUCIONET E PËRKUJDESIT SHOQËROR



Vera kërkon me patjetër plazh dhe qejf për të qenë e bukur!  
Fëmijët e institucioneve tona të përkujdesit gjatë Korrikut kanë pushuar dhe janë argëtuar në Shtëpinë tonë të Pushimit në plazhin e Velipojës.

Ne kujdesemi që përpos shërbimeve me standarde bashkëkohore brenda në institucion, përfituesve të shërbimeve tona të mos i mungojë argëtimi!